



Titulli i projektit

Ndërtimi i lulishtes “Partizani”, Bajram Curri

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja e projektit

Bashkia Bajram Curri

Buxheti i paravlerësuar

90,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Qyteti i Bajram Currit ka një popullsi prej 5340 banorësh, të ndarë në tre lagje përkatesisht “28 Gushti”, “Dardania” dhe “Partizani”. Lagjia “Partizani”, e pozicionuar në pjesën veriperëndimore të qytetit ka rreth 3600 banorë dhe 840 familje. Në këtë lagje, ku banojnë rreth 43% e banorëve të qytetit Bajram Curri, mungojnë kushtet për një jetë të përshtatshme dhe të kulturuar në komunitet. Në një sipërfaqe prej 1500 m², banorët nuk gëzojnë një mjedis sipas standardeve, pasi hapësirat publike janë në gjendje jo të përshtatshme për shkak të mungesës së buxheteve për mirëmbajtjen e tyre. Aktualisht, ka një mungesë të hapësirave të gjelbërta dhe rrugëve midis pallateve. Po ashtu, trotualet dhe ndriçimi mungojnë. Në këtë lagje është rritur vazhdimisht edhe nevoja e vendeve të parkimit, të cilat më parë nuk janë konsideruar si mjedise të nevojshme për komunitetin. Banorët e kësaj lagjeje dhe sidomos fëmijët dhe të moshuarit, nuk kanë vende të përshtatshme për t’u çlodhur dhe argëtuar. Kryesisht, për fëmijët mungojnë këndet e lojrave dhe hapësirat për të kaluar kohën e lirë dhe pa u rrezikuar. Investimet e mëparshme në këtë lagje pothuaj nuk ekzistojnë më. Projekti është në përputhje me studimin e zonës funksionale Tropojë përsa i përket përmirësimit të kohezionit social të komunitetit.

Qëllimi/et specifike të projektit

Objektivat specifike përfshijnë:

1. Përmirësimi kushteve të komunitetit për çlodhje dhe argëtim në lagjen “Partizani”, qyteti Bajram Curri.
2. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e ambienteve publike

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme të projektit përfshijnë:

1. Sipërfaqe të gjelbërta të shtuara;
2. Mjedis të përshtatshme për lëvizjen e banorëve, ndriçimin dhe parkimin e automjeteve;
3. Sipërfaqe çlodhëse të shtuara për banorët,
4. Komunitet i ndërgjegjësuar për mirëmbajtjen e investimit të kryer.

Numri i popullsisë përfutuese është rreth 3600 banorë të qytetit Bajram Curri (rreth 43% e popullsisë së qytetit Bajram Curri).

PROJEKTI 11



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore të projektit përfshijnë:

1. Sistemimi i terrenit në një sipërfaqe prej 1500 m²;
2. Ndërtimi i trotuareve;
3. Ndriçimi i lagjeve;
4. Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe vendosja e stolave;
5. Sistemimi i vendit të parkimit;
6. Krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta;
7. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e investimit të kryer.

Afati i përfundimit të projektit është 6 muaj

Maturimi i projektit

Propozimi përfshihet në funksionet e drejtpërdrejta të Bashkisë Tropojë. Ky propozim është në fazën e një projekt-ideje.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Projekti do të realizohet nga Bashkia Tropojë.

Financuesit e projektit përfshijnë: Bashkia, komuniteti, biznesi, donatorë vendas dhe të huaj.

Kostot e projektit

Kostoja totale e projektit është afërsisht 90,000 Euro.